



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr. 603 Prot.

Laç, me 22.02.2022

V E N D I M - S H P A L L J E

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)

Ne Laç, sot me date 22.02.2022.

Une, Mikeda Cenaj, me detyrë Permbarues Gjyqësore pranë Zyres Permbarimore Kurbin, pasi studiova aktet proceduriale të çeshtjes permbarimore Nr.289 rregj. të vitit 2022 bazuar në Urdherin e nr.10/1 të datës 10.01.2022 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korce,

KONSTATOVA:

Se në datë 20.01.2022 është depozituar pranë Zyres së Permbarimit kërkesa e kreditorit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korce së bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" të Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqësor) nr.53 datë 01.02.2021 të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Korce, me palë dhe objekt si më poshtë:

- Kreditor: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korce.
- Debitor: Fation Mark Fufi i dtj.22.08.1999 me banim në Rr."Unaza",Nd.30,H.3,Ap.28,Laç.
- Me objekt: Pagim shpenzime proceduriale në masën 1000-leke dhe T.F.P.

Nga ana e kësaj zyre kanë filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 datë 18/01/2001 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqësor" të ndryshuar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone në bashkëpunim me organet kompetente rezultoi se debitori Fation Mark Fufi nuk merr dijeni për aktet permbarimore nepermjet sherbimit postar pasi rezultoi i larguar jashtë shtetit sipas konfirmimeve të tyre, ndërsa sipas shkresës zyrtare të Z.GJ.CIVILE Laç është banor i kësaj zyre dhe si rezultat i kësaj bazuar në nenin 133/a 133/b dhe 144/a të K.Pr.Civile duhet të behet njoftimi me shpallje i debitorit lidhur me detyrimin që ai ka ndaj palës kreditore P.Rr.GJ.Korce për shpenzime proceduriale në masën 1000 leke plus tarifën fikse permbarimore.

Sa më sipër në mbështetje të neneve 133/a 133/b dhe 144/a të Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 datë 18/01/2001 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqësor" të ndryshuar

V E N D O S A

1-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njetzet) ditor (duke marrë parasysh edhe komunikimin postar) nga data 22/02/2022 - 13/03/2022 të debitorit Fation Mark Fufi i dtj.22.08.1999 me banim në Rr."Unaza",Nd.30,H.3,Ap.28,Laç.

2-Ky vendim perpilohet në disa kopje,ku një kopje afishohet në vendbanimin e fundit të palës debitore,një kopje afishohet në katin e njoftimeve të kësaj zyre, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Bashkisë Kurbin/Njesisë perberese,një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe një kopje i dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Permbarimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Fation Mark Fufi i dtj.22.08.1999 me banim në Rr."Unaza",Nd.30,H.3,Ap.28,Laç dhe me kalimin e këtij afati pala konsiderohet e njoftuar.

4-Pala debitore Fation Mark Fufi,duhet të paraqitet pranë Zyres Permbarimore Kurbin me seli në Lgji nr.4,Laç në katin e parë në ambjentet e Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe të marrë kontakt me permbaruesin gjyqësor të çeshtjes permbarimore për t'ju venë në dispozicion aktet permbarimore,pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve të nenit 519 e në vijim të K.Pr.Civile.

U shpall,sot me date 22.02.2022.

**PERMBARUES GJYQËSOR
MIKEDA CENAJ**